

BIBLIOTEKA

854
235



PREÇ ZOGAJ
qielli i
gjithkujt

POEZ

85H-1
1785

PREÇ ZOGAJ

*qielli
i gjithkujt*

- POEZI -



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor

ILIRIAN ZHUPA

Piktor

XHILDA PALOKA

Recensues

Bujar Skëndaj

PA CAK

Sot bie shi.
Magjistrat e përrallave hapin fletët dhe ikin,
Edhe unë iki sipër metaforave.

U mërzit lumturia këndeje enigmave,
Tani e ngriti figurativisht spirancën.
Kam vize nga Homeri, mbreti ynë demokrat,
Për t'u ngjitur pa cak.

Ç'hapësirë e rrafshhtë, e pandashme,
Limane qiellore me emrin Nëna Jote,
Shpirtra shëtitës në qiell të gjithkujt,
Pasqyrë që s'pasqyron, por i mton tokës
Fytyrën e vet. . .

Në shkrepat e Velës do ta pres shpirtin tim,
Endacakun që mbledh andej-këndeje figura.

shkurt 1990

MËNGJES — SHEMBËLLIM

Mëngjes, pasqyrë e madhe prej drite, prej
dielli —
Ku është vallë këtë minutë bota reale,
Ku është pema e vërtetë, toka e vërtetë?

Sepse më duket imazh gjithçka këtë minutë,
Edhe unë jam imazh
I atij që u zgjua
Dhe po shkon të dorëzohet.

Vegullimi kalon...
Menjëherë i hap krahët
Dhe asgjë s'më largohet.

ÇASTI I RREZIKSHËM

Çasti i rrezikshëm
Si top rrokulliset
Rrugëve të fatit.

Mbushur stih,
Etjeshpërthyes,
Me sytë e verbër
Na josh ta shkelim.

E nanuririm,
E përkëdhelim...

Oh, ç'fjalë të ëmbla për bukën thatë
Për rrenat pompoze, oh ç'heshtje e gjatë.
Ç'kujdes në të ecur dhe... nuk na shtyp
C'fuqi për të qeshur, shembullore për vitrina,
Jo, jo, nuk them
Pse dhëmbët më ranë,
Pse gishtat m'u paknë

E kërcet m'u thanë
Se dua të rroj sot e pastaj
Dhe rroj pa faj.

Mbushur stih,
Etjeshpërthyes,
Çasti i rrezikshëm
Mbetet prapa...
E shkëputur dritet
Si fushë e minuar.

IKJE

Kur zogu prijës i vjeshtës klithi,
Shpirti im rrahu flatrat në xhama: *Me 70 jorë*
Ikim nga plazhi, o shoqe, o motër.
Deti po derdhet në telepatinë
Për zbrazje librash, muzesh, urnash,
Gjërat s'durojnë më të thuhën.

Në ashtin e heshtjeve
po ngulen
si thika vetimat!

Skicohen heronjtë
Qysh më parë të plagosur.

Shtator, 1988

APOLOGJI

Për pak arrita qiellin, qiellin e poetit,
Kur isha djalë i ri me flatra në gji,
Kushedi sa lajme do t'u sillja, por
M'u desh të zbres atbotë se prejardhje —
Tunel i gjatë, ndriçuar zbehtë me eshtra të
holla,
Për fat e për dreq babagjyshat kishin ngrënë
barishte

Dhe unë sërish
U nisa t'arrij qiellin.

Nuk ishte e lehtë të fluturoje gjallë,
Qysh ditën e parë nëna ime e gjorë
Me lot e mbushi djepin ku linda.

Për pak arrita qiellin, por ah lotët e saj!
Për pak e arrij qiellin, por ah ky tren i vjetër
Më ngujon me orë nën portale që pikojnë
Trishtim qesëndinë e avujve të verës.
Kur do të nisemi? Kur do të mbërrijmë?

Asgjë nuk dihet saktë prej këtu.
Kam probleme me trupin.
Ç'barrë ta shpie andej-këndeje,
Ç'barrë ta ushqej —
Kam probleme me shpirtin:
E tanishmja zëvendëson pikërisht të

pastajmen,
Të qarat e fëmijëve më ngulen xhepave, *Mevoja*
Një trëndafil që vyshket
M'i bën me faj mendimet,
Mallkimi i lashtë rro të rrosh
Rrëshqet në trase duke qeshur...
Po unë do ta arrij, do ta arrij qiellin
Makar atë çast kur të shtyp hijen time.

dhjetor, 1989